



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHËRBIMI I PROVËS

Nr. 512₁₂ prot., datë 28 . 05 . 2025



Nr. 473₄ prot., datë 28 . 05 . 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

Sot më datë 28 / 05 / 2025, lidhet kjo akt-marrëveshje e re midis palëve, si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me adresë: Rruga “Jordan Misja”, Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës (në mungesë), Drejtori i Mbikëqyrjes Elektronike **Z. Eris SHESHI**,

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, me adresë: Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk”, kryqëzimi i 21 Dhjetorit, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Ergys QIRICI**.

DUKE MARRË NË KONSIDERATË:

- Qëllimin e përbashkët për funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe përmbushjen e objektivave;
- Nevojën për një bashkëpunim ndërinstitucional në ofrimin e shërbimeve më efektive.

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim referuar “*Marrëveshja*”), si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e marrëdhënieve institucionale në kuadër të bashkëpunimit mes dy institucioneve në lidhje me ndihmën e ndërsjellë në përmbushjen e detyrave të tyre ligjore dhe administrative si dhe për funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë. Përmes bashkëpunimit, të dy institucionet do të kontribuojnë në promovimin e drejtësisë sociale dhe luftimin e diskriminimit duke garantuar që të gjithë individët të kenë akses të barabartë në sistemin e drejtësisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 8, shkronja g) të ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në ligjin nr. 78/2020, datë 25.06.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, të ndryshuar.

Neni 3

Qëllimi

Të dy palët do të angazhohen për të ndarë informacionin e nevojshëm në mënyrë që të maksimizohet efektiviteti i veprimtarisë së tyre. Këmbimi i informacioneve ndërmjet Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror dhe Shërbimit të Provës mund të ndihmojë në identifikimin e rasteve të ndryshme dhe njoftimin e masave të nevojshme për zgjidhjen e tyre. Bashkëpunimi ndihmon në identifikimin e mangësive në procedurat ekzistuese dhe në zhvillimin e praktikave më të mira për menaxhimin e rasteve dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Neni 4

Detyrat e Palëve

Të dyja palët marrin përsipër, brenda mundësive dhe me vullnetin e tyre të lirë, të vënë në dispozicion të njëra tjetrës, informacionin e nevojshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si:

1- Vënia në dispozicion e adresave të qytetarëve, pjesë të proceseve të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore si pranë Shërbimit të Provës ashtu edhe pranë Shërbimit Përmbartimor.

2-Njoftimin e personave në mbikëqyrje, që ndodhen në proces ekzekutimi të vendimeve gjyqësore, mbi shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto të fundit.

3-Shërbimi i Provës merr përsipër, me vullnetin e tij të lirë, të informoj personat nën mbikëqyrje mbi mundësinë e shlyerjes së detyrimeve të shpenzimeve gjyqësore pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

4- Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor merr përsipër kryerjen e veprimeve përmbartimore sipas dispozitave ligjore.

Neni 5

Ndryshimi i marrëveshjes

1.Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm në dakortësi të palëve, nëpërmjet komunikimit me shkrim.

2.Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

3. Të dhënat e personave të kontaktit janë të bashkëlidhura në aneksin 1 të kësaj marrëveshje.

Neni 6

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje zbatohet për një periudhë 4(katër) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi, me mundësi rinovimi pas përfundimit të këtij afati dhe me konsensusin e palëve nënshkruese.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin, ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 8
Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.
3. Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve financiare ndërmjet palëve.

PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
(Në mungesë)

DREJTORI I MBIKËQYRJES
ELEKTRONIKE

ERIS SHESHI



PËR
SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR
SHTETËROR

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI



Aneksi 1: Personat e Kontaktit.

Përfaqësues për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës:

Emër Mbiemër: Eristjana Karçanaj

Pozicioni: Specialist, Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Tiranë

Adresa: Rruga “Jordan Misja”, Ndërtesa 6/1, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë

Tel: 0697303014

Email: eristjana.karcanaj@sherbimiproves.gov.al

Përfaqësues për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit:

Emër Mbiemër: Klaudja Lleshi

Pozicioni: Inspektor

Adresa: Sheshi “Mustafa Kemal Atatürk”, kryqëzimi i 21-Dhjetorit

Tel: 0684218200

Email: klaudja.lleshi@dpp.gov.al